



Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural

Në bazë të nenit 9 paragrafi 1 pika 6 nga Ligji për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për vendosjen e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë sipas Instrumentit për ndihmë në sektorin e politikës për "Bujqësi dhe zhvillim rural" (IPARD) (Gazetar zyrtare e RM nr. 38/2016), në bazë të pjesës II masë të investimeve në mjete financiare të bujqësisë pika 11, masë të investimeve në mjete materiale për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe produktet e peshkut pika 11 masa në Diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e biznesit pika 11 nga Programi për përdorimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë për zhvillim rural në Unionin Evropian (IPARD) për periudhën 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr. 177/2016), dhe në bazë të nenit 6 nga dekreti për mënyrën dhe procedurën e shfrytëzimit të mbështetjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga IPARD 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr. 64/2016)

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural
më 26 dhjetor 2018 shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 02/2018

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga
IPARD Programi 2014-2020

1. Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) si institucion përgjegjës dhe organ kontraktues për zbatimin e Instrumentit për ndihmë qasëse për zhvillim rural të BE (IPARD) ju bën thirrje të gjithë personave fizik dhe juridik të Republikës së Maqedonisë të dorëzojnë kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD programi 2014-2020 për masat në vijim:

1. Investime në mjete materiale të ekonomive bujqësore

2. Mbështetja financiare për këtë Thirrje publike është e përbërë nga 75% mjete të siguruara nga Instrumenti për ndihmë qasëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD) në përputhje me Marrëveshjen Financiare 2014-2020 dhe 25% mjete të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

3. **Mjete financiare sipas kërkesës individuale** shpërndahen si mbështetje financiare e pakthyeshme (grant) në shumë prej:

3.1. 60% nga vlera e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të investimeve për masën "Investime në mjete materiale të ekonomive bujqësore". Përqindja rritet deri 65% për investime në ekonomi bujqësore të propozuara nga bujqit e rinj (person fizik të moshës prej 18 deri 40 vjet në ditën e posedimit të kërkesës për mbështetje financiare) dhe 70% për investime në ekonomitë bujqësore në zonat malore.

4. **Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është më 9 shkurt 2019.**

5. **Mbështetja totale financiare në kuadër të kësaj thirrje publike është 11.883.772,00 euro ose 730.792.598,00 den.**

VËREJTJE: FURNIZIM I TRAKTORIT NUK ËSHTË SHPENZIM I PRANUESHËM NË KËTË THIRRJE PUBLIKE!

Tërheqje të formularëve dhe udhëzime:

Formularët e nevojshëm për "Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2014-2020" si dhe "Udhëzuesin për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2014-2020" në të cilët janë të përmbajtur të gjitha informatat për kriteret, kushtet për pranueshmëri të projekteve dhe kushtet për financim dhe informatat tjera të cilët janë të nevojshme për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020, Udhëzues për përgatitjen e Planit Afarist/Propozim Projektit Teknik, Udhëzimet për dhënien e dokumentacionit të nevojshëm nga institucionet kompetente dhe informacione të tjera të dobishme në versionin elektronik mund të merren nga ueb-adresa e Agjencisë: www.ipardpa.gov.mk.

6. Mënyra e dorëzimit të kërkesës:

Kërkuesi duhet të plotëson dhe të dorëzon Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 për masë individuale, Plan Afarist të përgatitur sipas Udhëzuesit për përgatitjen e Planit Afarist ose Propozim projektit teknik dhe dokumentacionit të shoqëruar siç është e cekur këtë Thirrje Publike.

Kërkesa e plotësuar për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 së bashku me Planin Afarist/Propozim projektin teknik dhe dokumentacionin e përgjithshëm të nevojshëm dorëzohet në zarf të mbyllur me shenjë në pjesën e përparme të zarfit në këndin e majtë të epërm "MOS E HAP" për Thirrjen Publike IPARD numër 02/2018 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dërgohet kërkesa. Kërkesa mund të dërgohet me postë si dërgesë e rekomanduar ose personalisht në sportelin e Agjencisë.

Vërejtje: Për shkak kryerjes së kontrollit në teren nga ana e Agjencisë duhet që kërkuesi të ketë në vetvete kopje nga dokumentacioni i përgjithshëm i dorëzuara deri te Agjencia.

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në e-mail adresën:

ipardpa.info@ipardpa.gov.mk ose në ueb-faqen: www.ipardpa.gov.mk.